Operatori ekonomik “ERGI” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9), për mjetet kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri në mënyrë të rregullt vetëm një kamion. Kamioni me targa EL 0128 C me kapacitet mbajtës 7.9 Ton. Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë kamion vihet re se certifikata e kolaudimit nuk është e vlefshme pasi ajo ka skaduar më datën 26.10.2017

Sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me mjetet kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 5 ton dhe max 10 ton secili nuk është i saktë, rrjedhimisht i pavlefshëm

Operatori ekonomik “ERGI” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9), për mjetet kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximumi 5 ton për secilin kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë kamion me këtë tonazh. Sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me mjetet kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës min 3.5 ton dhe max 5 ton secili nuk është i saktë, rrjedhimisht i pavlefshëm

Shoqëria “Ergi” shpk ka paraqitur gjithashtu mjete të cilat i ka siguruar me kontratë me qera, por sipas verifikimit mjetet e siguruara me qera nuk mund të konsiderohen të rregullta pasi nuk janë siguruar për kontratën objekt prokurimi, pra i është referuar një objekti konkret duke përjashtuar në këtë mënyrë cdo objekt tjetër.

Shoqëria “Ergi” shpk ka paraqitur gjithashtu në shtojcën nr.9 Kamionçinë me targa AA657JY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.5 Ton dhe nga verifikimi i dokumentacionit për këtë kamionçinë vihet re se polica e sigurimit nuk është e vlefshme, pasi ajo ka skaduar më datën 07.09.2017.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3-Oferta e Operatorit Ekonomik “KOLA INVEST” shpk

Operatori ekonomik “KOLA INVEST” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri dy kamiona nga tre te kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë ne lidhje me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës secili minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton, për rrjedhojë i pavlefshëm

Operatori ekonomik “KOLA INVEST” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion një Fadromë me goma dhe një Eskavator me goma 0.25m³, për ekzekutimin e kontratës.

Operatori Ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri ka deklaruar në shtojcën 9, fadromë copë 1 në pronësi. Për fadromën është paraqitur akti i zhdoganimit me nr serie 297 dtaë 24.01.2010 por nuk është paraqitur për këtë mjet çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, leja e qarkullimit mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 12, gërma (a).

Operatori Ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri ka deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma copë 2 me kontratë qeraje nr.1573 rep dhe 1104 kol si dhe eskavatori tjetër me kontratën me nr 599 rep dhe 436 kol . Për eskavatorët me goma shoqëria nuk ka paraqitur lejë qarkullim, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, C’ka bie në kundërshtim me “Kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti Teknik pika 12, gërma (a)

Pra sa më sipër cituar eskavatorët me goma si dhe fadroma me goma nuk kanë lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë ne lidhje me eskavatorin me goma dhe fadromën me goma për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4- Oferta e Operatorit Ekonomik “KACDEDJA” shpk

Operatori ekonomik “KACDEDJA” shpk, nuk plotëson pikën 5.2, gërma b të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit, ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person)

(Për ekspertin zjarrfikës të certifikuar dhe kontratën e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit si dhe të rezultojë në listat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

Shoqëria Kacdedja shpk ka paraqitur në përmbushje të kriterit të mësipërm si ekspert zjarrfikës punonjës me inicialet B.R, nga verifikimi i dokumentacionit të këtij operatori rezulton që punonjësi i mesiperm nuk rezulton në listat e shoqërisë për periudhën Maj 2017- tetor 2017 pra nuk rezulton për asnjë nga 6 muajt e kërkuar nga AK, Bashkia Tiranë në dokumentat standarte të tenderit.

Për sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë kriter është i paplotë rrjedhimisht i pavlefshëm.

Operatori ekonomik “KACDEDJA” shpk, nuk plotëson pikën 5.1 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit

Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listat e shoqërisë për të paktën gjashtë muajt e fundit 20 (njëzet) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Kategori I- 4(katër) punonjës, Kategori II-5 (pesë) punonjës, Kategori III- 7(shtatë) punonjës, Kategori IV-3 (tre) punonjës, Kategori V- 1 (një). (Për punonjësit e siperpermendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat e punës të vlefshme).

Operatori ekonomik i mesiperm ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri punonjës me kategori të I, II, dhe të V sakte, por nuk ka paraqitur punonjësit e kërkuar nga AK, në dokumentat e tenderit për kategoritë e tretë dhe të katërt. Pra referuar sa më sipër, Operatori Ekonomik, ka paraqitur, 4 punonjës me grup të I-rë, 5 punonjës me grup të II-të nga pesë të kërkuara, 4 punonjës me grup të III-të nga 7 punonjës të kërkuar, 2 punonjës me grup të IV-të nga 3 punonjës të kërkuar, dhe 1 punonjës grupi i V-të. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Operatori ekonomik “KACDEDJA” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion dhe dy kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës secili minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton për ekzekutimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri një kamion nga tre te kërkuar nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu për kategorinë e mjeteve me kapacitet mbajtës nga 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion, AK ka kërkuar dy mjete me tonazhin e mësipërm ndërsa shoqëria ka sjellë në përmbushje të këtij kriteri vetëm një mjet. Kamionat e tjere te paraqitur nga Operatori ekonomik ne shtojcen 9 kanë kapacitetin mbajtës mbi 10 ton.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë ne lidhje me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës secili minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton, si dhe kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës secili minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5- Oferta e Operatorit Ekonomik “S.A.G” shpk

Operatori Ekonomik “S.A.G” shpk nuk plotëson pikën 2.1 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit shoqëria “S.A.G” shpk nuk ka paraqitur në përmbushje të kriterit të mësipërm Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017 ashtu sic edhe është kërkuar në dokumentat Standarte të Tenderit.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar duke mos paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2017 të kërkuar nga AK

Operatori Ekonomik “S.A.G” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit

Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë

Sa më sipër Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “S.A.G” shpk është i paplotë pasi nuk ka

përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ eskavatorist të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër shoqëria "S.A.G" shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Operatori ekonomik "S.A.G." shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion një autobot uji për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik "S.A.G" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon vetëm një mjet autobot uji me targë AA646 Gt nga verifikimi në dokumentacion për këtë mjet rezulton se certifikata e kolaudimit ka skaduar më datën 15.12.2017 pra i ka skaduar afati i vlefshmërisë për këtë mjet lidhur me certifikatën e kontrollit teknik:

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, për autobotin e ujit është i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6- Oferta e Operatorit Ekonomik "CURRI" shpk

Operatori ekonomik "CURRI shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9), për mjetet kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomikë nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnje kamion vetëshkarkues me këtë tonazh, pasi Kamionet e deklaruar nga operatori ekonomik kanë kapacitetin mbajtës mbi 10 ton dhe poshtë 3.5 ton .

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton te kerkuar nga AK (3 cope) , për rrjedhojë i pavlefshëm

Operatori ekonomik "CURRI" shpk, nuk plotëson pikën 5.1 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit. AK në dokumentat Standarte te Tenderit/Kapaciteti Teknik për realizimin e kontratës ka kërkuar si më poshtë

5.1 Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për të paktën gjashtë muajt e fundit 20 (njëzet) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Kategori I- 4 (katër) punonjës, Kategori II-5 (pesë) punonjës, Kategori III- 7 (shtatë) punonjës, Kategori IV-3 (tre) punonjës, Kategori V- 1 (një). (Për punonjësit e siperpermendur të paraqiten deshmë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat e punës të vlefshme).

Operatori ekonomik i mesipër ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri punonjës me kategori të I, II, IV, V saktë por nuk ka paraqitur punonjësit e kërkuar nga AK, në dokumentat e tenderit për kategoritë e treta. Konkretisht shoqëria "CURRI" shpk ka paraqitur vetëm dy punonjës me kategori të tretë nga shtatë të kërkuar dhe përkatësisht punonjësit me initiale L.P dhe F.C.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7- Oferta e Operatorit Ekonomik "INERT" shpk

Operatori ekonomik "INERT" shpk, nuk plotëson pikën 5.2 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me "Certifikatë për auditimin e energjië)

Operatori Ekonomik "INERT" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si auditues energjie Z. A.R për të cilin ka paraqitur një certifikatë ku citohet se ka frekuentuar kurs për auditues energjie por ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor ka kërkuar Certifikatë (DIP) për eficientë në energji.

Për sa më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur 1 punonjës auditues energjie sipas formatit të kërkuar nga AK.

Për sa më sipër shoqëria Inerti shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Operatori Ekonomik "INERT shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit

Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjetëve të rënda ng ate cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatori Ekonomik i mësipërm nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmi drejtimi të vlefshme për automakinist.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjës manovrator/ automakinist të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Operatori ekonomik “INERT shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9), për mjetet tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion, dy kamiona vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton per secilin kamion dhe dy kamioncina kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion dy Kamioçina kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton , tre Kamiona vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion,) si dhe dy Kamiona vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton per secilin kamion) për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterëve të mësipërm ka deklaruar Kamionçinë me targa AA577 KR e cila është deklaruar në shtojcë por që nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik në sistemin e app-së nuk u gjet asnjë dokument që të vërtetonte ekzistencën e këtij kamioni

Kamion me targa AA708PN e cila është deklaruar në shtojcë por që nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik në sistemin e app-së nuk u gjet asnjë dokument që të vërtetonte ekzistencën e këtij kamioni

Kamionçinë me targa TR4942 T është me kapacitet mbajtës 3.3 Ton.

Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të kriterëve të mësipërm vetëm 1 kamion që i përket kategorisë 5-10 ton.

Operatori ekonomik ka paraqitur një deklaratë ku citon se është e panevojshme paraqitja e kamionave me kapacitet të kërkuara nga AK, në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor”, ligjvënësi ka parashikuar ankimimin për dokumentat e tenderit, pra operatori ekonomik ka patur mundësi të ankimohet për dokumentat e tenderit para hapjes së procedurës së prokurimit. Pjesëmarrja e tij në këtë procedurë dhe paraqitja e ofertës nga ana e shoqërisë presupozon që ka marrë persipër të përmbushë të gjitha kriteret që Autoriteti Kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Këto krirer të vendosura nga ana e autoritet kontraktor nuk janë kontestuar nga ana e operatorit ekonomik pra janë konsideruar nga ana e këtij operatori si kriterë në përputhje të plotë me ligjin dhe aktet nenligjore në fuqi.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i plotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8- Oferta e Operatorit Ekonomik “PIENVIS” shpk

Operatori ekonomik “PIENVIS” shpk, nuk plotëson pikën 5.2, gërma b të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit, ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person) (Për ekspertin zjarrfikës certifikatë e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

Shoqëria “PIENVIS” shpk ka paraqitur në përmbushje të kriterit të mësipërm si ekspert zjarrfikës një marrveshje për bashkëpunim për punimet e MNZ-së me nr 5697 Rep dhe 1905 kol datë 16.12.2017 me një shoqëri.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit që operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë të punësuar, të rezultojë në stafin e shoqërisë punonjës ekspert zjarrfikës dhe për të paraqitur dokumentacioni përkatës gjithashtu eksperti zjarrfikës duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit. Nga verifikimi I dokumentacionit të këtij operatori rezulton që eksperti zjarrfikës nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga AK, Bashkia Tiranë.

Për sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë kriter është i pavlefshëm.

Operatori Ekonomik “PIENVIS” shpk, nuk plotëson pikën 5.1 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit. AK në dokumentat Standarte të Tenderit/Kapaciteti Teknik për realizimin e kontratës ka kërkuar si më poshtë

5.1 Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për të paktën gjashtë muajt e fundit 20 (njëzet) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI

ose nga institucione ekuivalente me të. Kategori I- 4(katër) punonjës, Kategori II-5 (pesë) punonjës, Kategori III- 7(shtatë) punonjës, Kategori IV-3 (tre) punonjës, Kategori V- 1 (një). (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Operatori ekonomik i mesiperm ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri punonjes me kategori te I, II, III dhe të V sakte, por nuk ka paraqitur punonjesit e kerkuar nga AK, ne dokumentat e tenderit per kategorine e katërt .

Pra referuar sa më shoqëria nuk ka paraqitur asnjë punonjës me kategori të katërt.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

9- Oferta e Operatorit Ekonomik “BRUÇI” shpk

Operatori Ekonomik “BRUÇI” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 2 gërma dh) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Shoqëria “BRUÇI” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 9932 Prot. datë 14.11.2017 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në muajin tetor, pra pa përfshirë faturën koherente të muajit tetor 2017. Referuar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Tetor 2017.

Në zbatim te VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.”

Për sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me këtë kriter është i pavlefshëm.

Operatori Ekonomik “BRUÇI” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 4, Një punësim mesatar i të paktën 40 (dyzetë) personave, për periudhën Tetor 2016 - Tetor 2017

Shoqëria “BRUÇI” shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot TR00045597, datë 05.12.2017 për muajt Tetor 2016-Tetor 2017, si dhe në list pagesat për periudhën Tetor 2016-Tetor 2017 rezulton të ketë një numër mesatar prej 37 punonjësish.

Pra sa më sipër shoqëria “BRUÇI” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit//Kapaciteti Teknik pika 4, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Operatori Ekonomik “BRUÇI” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014,2015, 2016) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 34.999.995 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

Shoqëria “BRUÇI” shpk në vërtetim të këtij kriteri ka paraqitur në sistemin elektronik të app-së vërtetim xhiroje për vitin 2014, 2015, 2016, ku del qarte që xhiroja mesatare e tre viteve të sipërcituar është 14.756.018 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) lek pa TVSH që do të thotë operatori ekonomik nuk plotëson xhiron e kërkuar nga AK, Bashkia Tiranë.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me kapacitetin ekonomik në pikat 2 e kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit /Kriteret e veçanta të Kualifikimit është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Operatori Ekonomik “BRUÇI” shpk, nuk ka paraqitur ne sistemin elektronik te App-se, duke mos përmbushur pikat 6,9,10 dhe 11 te Kriteret e veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik

6. Certifikaten e cilesise se punimeve ISO 9001- 2008 (e vlefshme)

9. Certifikatë PAS 99-2012(e vlefshme)

10. Certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme)

11. Certifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme).

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me kapacitetin teknik, Kriteret e veçanta të Kualifikimit është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.12.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në

bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik “Colombo” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 101 Prot. datë 03.01.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: ”Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare ”Dëshmorët e Lirisë”.

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 165 Prot. dt. 03.01.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 165/1 Prot. datë 03.01.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e Operatorit Ekonomik, “Colombo” shpk, ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik i mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik “Colombo” shpk, me ane të shkresës Nr. 101/2 datë 05.01.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 16.01.2018, me anë të shkresës nr. 165/2, është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Klajger Konstruksion” shpk & VARAKU-E shpk” me adresë: Tiranë, Kamëz, Bathore 6, pranë Kopshtit të Fëmijëve, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH 28.523.046 (njëzet e tetë milion e pesëqind e njëzet e tre mijë e dyzet e gjashtë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit, është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme pa TVSH, = 32.232.518 (tridhjetë e dy milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e peseqind e tetembedhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

SH. A UJËSJELLËS – KANALIZIME CËRRRIK

Cërrik më 16.01.2018

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: [Blerimi sh.p.k.]

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksione të linjave të brendshme të rrjetit të ujësjellësit Sh.a.UKC “ me vlerë 7387169 (shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. Kjo vlerë është percaktuar ne regjistrin shtese te prokurimeve publike te derguar prane APP-se, per kete autoritet kontraktor.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [18.12.2017] [Numri 50]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Blerimi sh.p.k	J62903384G	
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it	
6943526 (gjashte million e nenteqind e dyzet e tre mije e peseqind e njezet e gjashte) leke pa tvsh.		
(me numra dhe fjalë)		
Colombo sh.p.k	J61922018S	
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it	
4.391.304 (kater million e treqind e nentendhjet e nje mije e treqind e kater) leke pa tvsh.		(me
numra dhe fjalë)		
3. IMAG sh.p.k & BELADI sh.p.k	J82816206R	
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it	
6115790 (gjashte million e njeqind e pesembedhjet mije e shateqind e nentendhjet) leke pa tvsh.		
(me numra dhe fjalë)		
4. Viante Konstruksion sh.p.k	K47103804L	
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it	
5,024,535.60 (pese million e njezet e kater mije e peseqind e tridhjet e pese pike gjashte) leke pa tvsh.		
(me numra dhe fjalë)		

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Colombo sh.p.k - Per arsyet e meposhtme:

Operatori ekonomik nuk e ploteson kushtin per Kapaciteti teknik kontrata te ngjashme te se njejtes natyre. Per kete rast operatori ka paraqitur si objekt te ngjashem Nderimin e ujesjellesit Vermik Ramice ku ky operator pretendon se eshte nenkontraktor. Ne VKM nr 1 date 10.01.2007 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar percaktohet se: Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin, për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t’ia transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti kontraktor lejon, në veçanti, nënkontraktimin, për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve, të vegjël e të mesëm, ekonomikë. Si dhe Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët, shërbimet ose mallrat, ose një pjesë të tyre, që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe nënkontraktorin e përzgjedhur. Nënkontraktori duhet të zotërojë kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve, që do të kryejë, ose për mallrat, që do të furnizojë. Per rastin konkret kemi mangesite e meposhtme:

Ne formularin e vleresimit percaktohet se Colombo sh.p.k. ka kryer 51% te punimeve kur ne LPP dhe ne Ne VKM nr 1 date 10.01.2007 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar

percaktohet se:....Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40 % të vlerës së kontratës dhe mund të kufizohet te punët, shërbimet ose mallrat e veçanta....

Qofte ne situacionin e punimeve por dhe ne kontrate mes paleve nuk percaktohen punët, shërbimet ose mallrat, ose një pjesë të tyre, që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë. Per kete arsye eshte e pamundur te konstatojme nese jane nenkontraktuar punimet e germimit apo zerat e ngjashem te kerkuara per kete procedure prokurimi. Gjithashtu dhe ne kete rast eshte vepruar ne kundërshtim me LPP dhe VKM nr 1 date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar cka e ben kete dokument te paraqitur te pavlefshem per pjesemarrje ne prokurimet publike.

Ne liste pagesat e paraqitura per numrin e te punesuarve dhe qe u jane paguar detyrimet per kontributet e tyre per periudhen Janar-Nentor 2017 konstatohet se ne te gjithë periudhen vetem nje numri mesatar prej 15 punonjesve ne muaj u jane paguar detyrimet per te gjithë periudhen mujore ndersa punonjesit e tjere kane punuar me kohe te pjesshme.

Operatori ekonomike nuk ka paraqitur:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	SASIA	Detaje
	Mjet Germimi me goma	Cope 1	Operatori ka paraqitur vetem nje mjet germimi me goma nga dy te kerkuar. Nje fakt I tille konstatohet dhe nga shtojca nr 9 e plotesuar nga operatori.
	Mjet germimi me zinxhire	Cope 1	Nga foto e paraqitur konstatohet qe mjeti (eskavator) I paraqitur eshte me goma, pra ne kundërshtim me kerkesat per kualifikim. Po kestu ky mjet nuk eshte I targuar dhe I mungon dokumentacioni i kerkuar per mjetet qe shenohen ne regjistrat publike.

IMAG sh.p.k & BELADI sh.p.k - Per arsyet e meposhtme:

Ne akt-marreveshjen ndermjet shoqerive percaktohet vetem perqindja e ndarjes se punimeve dhe jo ndarja sipas elementeve konkrete te punimeve.

Në Kreun VIII ("Kushte të përgjithshme për zbatim"), neni 74 ("Bashkimi i operatorëve ekonomikë"), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

"1. ...Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi."

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin 2.7.2 sipas te cilit duhet te paraqesin kontrate furnizimi per paisje thidraulike me prodhuesin te shoqeruar me certificate ISO per cilesine e paisjeve ne emer te prodhuesit. Kontrata e furnizimit te jete noteriale.

Operatori ekonomik IMAG sh.p.k per plotesimin e kriterit te mesiperme ka paraqitur nje kontrate (jo noteriale) midis Porositetit (IMAG sh.p.k) dhe Furnizuesit (ËAT 2010 sh.p.k). Sic dokumentohet ne dokumentacionin bashkengjitur kontrates ËAT 2010 sh.p.k eshte vete nje shoqeri porositese tek prodhesi PESTAN dhe jo prodhues i materialeve hidraulike sic kerkohet ne piken 2.7.2.

Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.1 te kapacitetit teknik, pasi per vertetimin e ketij kriteri nder te tjera kerkohet dhe procesverbali I marrjes ne dorezim te punimeve te se njejtës natyre per nje object tevetem, procesverbal i cilimungon ne dokumentacionin e dorezuar nga operatori ekonomik IMAG.

Viante Konstruksion sh.p.k - Per arsyet e meposhtme:

Operatori nuk ka paraqitur një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Operatori ekonomik ka paraqitur Një certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka në vlerën 10% të fondit limit që prokurohet, të lëshuar nga BKT Dega Don Bosko me nr. 277 prot. date 27.12.2017. Kjo banke perdor vulen me datën e perditësuar brenda saj dhe ne vule konstatohet se data e lëshimit të ketij dokumenti është 12.12.2017. Operatori ekonomik jo vetem nuk ploteson afatin brenda 5 (pese) diteve nga data e hapjes së ofertave por ka nderhyre ne dokument ne kundershtim me DST ku percaktohet se: ...Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim..

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vertetim të lëshuar nga autoritetet lokale për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017.

Ofertuesi nuk ka paraqitur vertetim nga sig shoqerore apo dega tatimeve për numrin e të punësuarve dhe që u janë paguar detyrimet për kontributet e tyre për muajin Nentor 2017.

Ofertuesi nuk ka paraqitur liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore për muajin Nentor 2017,

Ofertuesi nuk ka të përfshirë në listë pagesa Ing Topograf

Ofertuesi nuk ka të përfshirë në listë pagesa Ing mjedisi

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur punonjes të kualifikuar 2 hidro

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrate noteriale me furnizuesin e tubacioneve dhe paisjeve të tjera hidraulike të shoqëruar me certifikatën ISO. Autorizimi i paraqitur nuk është i njëvlefshëm me kontratën noteriale gjithashtu ai është me vule të skanuar. Nga ana tjetër autorizuesit i ka skaduar Certifikata iso në datë 2 Prill 2017

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Blerimi sh.p.k. me adresë Elbasan se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6943526 (gjashtë milion e nentëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e njetëz e gjashtë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë SH. A UJËSJELLËS – KANALIZIME CËRRIK sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një

vlerë të përgjithshme prej [shuma në shifra dhe fjale], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.01.2018

Ankesa: Jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

BASHKIA TIRANE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” Loti i parë: “Blerje materiale pastrimi për Bashkinë Tiranë”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Loti i parë: “Blerje materiale pastrimi për Bashkinë Tiranë”.

Fondi limit në total: 1.091.667 (një milion e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Fondi limit Loti I: 654.950 (gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 29 datë 05.04.2017 “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 84 datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar)”.

Kohëzgjatja e kontratës: Operatori ekonomik duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 26.12.2017, ora 12:00

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 50 datë 18.12.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimimë i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Operatori ekonomik “ORPC Albania” shp.k NUIS L12227020K

Vlera e ofertës – 645.000 (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik “Ndertim Montimi e Re” shpk NUIS J73312211D

Vlera e ofertës – 650.750 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nuk ka operatorë ekonomik të skualifikuar:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “ORPC Albania” shpk, shpkme adresë:: Njësia Bashkiake nr.1, Rr. Petro Nini Luarasi, (kryqezimi në rrugën Todi Shkurti nr.6), pallati nr.7, Kati I-rë, Zona Kadastrale nr. 8160, nr. Pasurie 3/943, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 645.000 (gjashtëqind e dyzet e pese mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skënderbej”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 650.750 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:08/01/2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

BASHKIA TIRANE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” Loti i dytë: “Blerje materiale ndriçimi për Bashkinë Tiranë”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Loti i dytë: “Blerje materiale ndriçimi për Bashkinë Tiranë”.

Fondi limit në total: 1.091.667 (një milion e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Fondi limit Loti II: 436.717 (katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 29 datë 05.04.2017 “Për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak

të Tiranës Nr. 84 datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar)”.

Kohëzgjatja e kontratës: Operatori ekonomik duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 26.12.2017, ora 12:00

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 50 datë 18.12.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimimi i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

